



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 2.10.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 2.10.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Peka

Të nderuar zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

Referuar shkaqeve të ankimit, të paraqitura nga Komisioneri Publik për vendimin nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Peka dhe vendimit të ndërmjetëm të Kolegjit për pranimin e kërkesës së Komisionerit Publik, për kryerjen nga ana e Kolegjit të një analize financiare të periudhës 2003 – 2016, Komisioneri Publik, pasi u njoh me analizën financiare të kryer nga Kolegji, të dërguar pranë Institucionit të Komisionerëve Publik, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 23.9.2020, shprehet si vijon:

- Analiza financiare plotëson kërkesën e Komisionerit Publik, pasi përfshin analizën e mbulimit me burime nga të ardhura të ligjshme të shpenzimeve dhe të investimeve të kryera në pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete (*cash* dhe në bankë), të krijuara për periudhën e hetimit 2003 – 2016.
- Komisioneri Publik shprehet dakord me vlerat dhe zërat nga 1 - 14 të tabelës së analizës, që i përkasin seksionit të pasurive neto.
- Komisioneri Publik shprehet dakord me vlerat dhe zërat nga 15 - 17 të tabelës së analizës, që i përkasin seksionit të të ardhurave.
- Komisioneri Publik shprehet dakord me zërat nga 18 - 23 të tabelës së analizës, që i përkasin seksionit të shpenzimeve të mobilimit, jetesës, shpenzimeve për udhëtime për jashtë shtetit dhe pagesat e kredive në *** Bank dhe Bankën ***.***.
- Komisioneri Publik shprehet dakord me vlerat në zërat 41 dhe 42 të tabelës së analizës “Gjendja e llogarive bankare në fillim të vitit” dhe “Gjendja e llogarive bankare në fund të vitit”.
- Për sa i përket zërit me numër 43 – 44, referuar analizës financiare, viti 2005 rezulton me diferencë negative në shumën -133.601 lekë. Meqenëse në këtë vit subjekti ka deklaruar “Gjendje *cash*” në shumën 500.000 lekë, Komisioneri Publik vlerëson se kjo shumë e deklaruar, që gjendet jashtë sistemit bankar dhe që nuk justifikohet krijimi nga burime me të ardhura të ligjshme në vitin deklarues, kjo gjendje nuk duhet të merret në konsideratë, si e mbartur në vitin pasardhës apo si burim të ardhurash për vitin pasardhës e në vijim.

Komisioneri publik argumenton se në vitet ku analiza financiare rezulton negative, pra nuk mbulohen me të ardhura të ligjshme kursimet, investimet dhe shpenzimet e deklaruara apo të dokumentuara, atëherë nuk mund të konsiderohen si burim të ardhurash të ligjshme për vitet në vazhdim kursimet *cash* të deklaruara, por që gjenden jashtë sistemit bankar.

- Gjithashtu, referuar analizës së vitit 2010, lidhur me zërat: “Gjendja *cash* në fillim të vitit” dhe “Gjendja *cash* në fund të vitit”, të cilat përfaqësojnë likuiditete *cash* të deklaruara nga subjekti, por që gjenden jashtë sistemit bankar, konstatojmë se nuk janë përfshirë likuiditetet *cash* të deklaruara nga subjekti, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2010. Këtu subjekti ka deklaruar: “*Para të kursyera cash nga paga*”, në shumën 1.000.000 lekë dhe “*Para të kursyera cash nga Kredia në ****”, në shumën 1.500.000 lekë. Pra, gjendja e likuiditetit *cash* në analizë nuk përputhet me deklarinimin e subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA